



REPUBLIKA E SHQIPËRISË PRESIDENTI

26 Korrik 2021 Presidenti Meta emëron zotin Artur Kalaja gjyqtar të Gjykatës së Lartë

DEKRET

PËR

EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenit 93 dhe nenit 136 të Kushtetutës, nenit 48, pikat 11 dhe 13, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pas administrimit pranë Institucionit të Presidentit të Republikës në datë 19.07.2021, të propozimit të arsyetuar të përcjellë me shkresën me nr. 3390/2 prot., datë 19.07.2021 dhe Vendimit nr. 311, datë 16.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatit z. Artur Kalaja", shoqëruar me praktikën dokumentare të ngritjes në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur për kandidim me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendosa të:

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti **Artur Kalaja** emërohet gjyqtar i Gjykatës së Lartë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Nr. Dekretit 13173 Tirane, më 26.07.2021

